



Planuar / Dorezuar Primitjen/Prodato Received/Delivety	23.08	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org -Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHOCK	5787	2023	117



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.951/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zvrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.951/2023 të datës 12.07.2023, të parashtruar nga ankues _____, me adresë rruga _____, në Prizren, kundër Vendimit me Nr. 03/2023 të datës 19.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.951/2023 e datës 12.07.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anullohet Vendimi me Nr. 03/2023 i datës 29.06.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- III. Obligohet Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të bëjë zbatimin e këtij vendimit, duke ndërmarr veprimet me qëllim rishqyrtimin e kësaj lënde.
- IV. Obligohet Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [redacted] punësuar sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit me numër protokoli 2279/2017 të datës 25.05.2017 në pozitën "Zyrtar i Arkivit" në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 11.05.2023 mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit ka dërguar email tek Udhëheqësi i Njëjesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3, 3.5, 3.6, 3.8 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë për arsyet si në vijim: 1. Mospërbushje e detyrave të punës; 2. Braktisja e punës pse mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3. Kryerja e përsëritur, brenda se jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tersi, dhe 4. Shkelje e detyrimeve të përcaktuar në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.

Më datë 16.05.2023 rasti i ankuesit është përcjell tek Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 15.06.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.02/2023 me të cilin ka shtyrë afatin për përfundimin e procedura disiplinore ndaj ankuesit deri më datë 30.06.2023, ndërsa më datë 29.06.2023 ka nxjerr Vendimin me Nr. 03/2023 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalimi i 40% në pagë për periudhën 6 muaj si dhe ndalimi i ngritjes në detyrë duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 3 vjeçare".

Ankuesi përmes postës më datë 11.07.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 12.07.2023 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.951/2023 me numër protokoli 5135/2023, kundër Vendimit me Nr. 03/2023 të datës 29.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale ngase nuk ka argumentuar me asnjë provë pretendimit e iniciuesit të kërkesës, po ashtu ky komisioni i ka shqiptuar dy masa disiplinore në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.07.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ndërsa Këshilli më datë 20.07.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 5135/2023 të datës 12.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Zarin e datës 11.07.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 14.07.2023;

Përgjigjen në ankesë e datë 20.07.2023; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit të datës 25.05.2017; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës për ankesën i datës 14.02.2022 dhe 31.01.2023; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore përmes emailit i datës 11.05.2023; Emailin e datës 16.05.2023 nga E.S për anëtarët e Komisionit Disiplinor; Paralajmërimin verbal për ankuesin nga M.L i datës 06.04.2023; Vendimin me Nr. 03/2023 të datës 29.06.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 02.06.2023, 29.06.2023, 14.06.2023 Ftesë për seancë e datës 12.06.2023, 09.06.2023, 08.06.2023 për ankuesin; Ftesë për takim e datës 12.06.2023, 09.06.2023, 08.06.2023 nga Sh.I për M.L; Kërkesë për prova shtesë e datës 24.07.2023 nga A.B për T.B; Përgjigje e datës 24.07.2023; Vendimi me Nr. 02/2023 të datës 15.06.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Raporti i prezencës në punë për periudhën 03.01.2023 deri 30.08.2023 për ankuesin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 03/2023 të datës 29.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pretendon se për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale nuk ka argumentuar me asnjë provë pretendimet e iniciuesit të kërkesës, po ashtu ky komisioni i ka shqiptuar dy masa disiplinore në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat materiale të lëndës, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e inicimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit më datë 11.05.2023, ka theksuar se ankuesi ka bërë shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3, 3.5, 3.6, 3.8 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë për arsyet si në vijim: 1. *Mospërmbushje e detyrave të punës*; 2. *Braktisja e punës pse mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë*; 3. *Kryerja e përsëritur, brenda se jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tersi, dhe* 4. *Shkelje e detyrimeve të përcaktuar në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.*

Në kuptim të besueshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë lidhur me procedurën disiplinore të nëpunësve civilë, përkatësisht nenit 45 i cili ka pacaktuar përcaktuar se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit",*nenit 46 ku citohet se: *"1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta... ndërsa "Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmbushja e detyrave të*

punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë”, nenit 47 ku wshtw përcaktuar se: “Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”, dhe nenit 50, i cili ka përcaktuar : “1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore”.

Marr për bazë pretendimet që janë theksuar në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit dhe marr për bazë Vendimin me Nr. 03/2023 të datës 29.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës me rastin e vendimmarrjes në këtë procedurë nuk ka shqyrtuar dhe vendosur për të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore gjegjësisht Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar dhe vendosur vetëm për pretendimin e vijueshmërisë në punë, me ç’rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: “1. Komisioni disiplinor fillon menjëherë shqyrtimin e fakteve dhe provave në procedurën disiplinore pas pranimit të kërkesës për iniciim të procedurës disiplinore”, ngase Komisioni Disiplinor është i obliguar që të shqyrtoj të gjitha pretendimet e ngritura në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore dhe të vendos për secilin pretendim dhe varësisht nga provat materiale të lëndës ka qenë i obliguar të vendos për secilin nga pretendimet në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, rrjedhimisht Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me rastin e vendosjes vetëm për njërin nga pretendimet e inicuesit të procedurës disiplinore pa vendosur për pretendimet e tjera, ka vepruar në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “1. Arsytimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsytimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim”.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me rastin e pranimit të ankesës së ankuesit përmes kërkesës për përgjigje në ankesë të datës 14.07.2023 dhe kërkesës për prova shtesë të datës 24.07.2023 si prova materiale ka kërkuar *“Dëshmi për mos përmbushje të detyrave të punës apo dëshmi për shkelje të supozuara nga ana e ankuesit”*, mirëpo përveç Raportit të prezencës në punë për periudhën 03.01.2023 deri 30.08.2023 për ankuesin, nuk është dërguar asnjë dëshmi tjetër e që është e ndërlidhur me pretendimet për shkelje disiplinore si në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore.

Komisioni Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Vendimin me Nr. 03/2023 të datës 29.06.2023 thekson se: *“Ankuesi për periudhën janar-shkurt 2023 nuk ka ofruar asnjë dëshmi nga organi kompetent mjekësor për arsyetimin e mungesës në punë ngase raportet mjekësore të ofruara pranë Komisionit Disiplinor nga Burimet Njerëzore për z. A lidhur me gjendjen shëndetësore të tij nuk arsyetojnë të gjithë periudhën e mungesës në punë nga data 01 mars 2023 deri më datën 19 qershor 2023, për më shumë Komisioni Disiplinor konstaton se z.A nuk ka ofruar dëshmi për shfrytëzimin e pushimit të lejuar mjekësor dhe pushimet të tjera përmes procedurës së rregullt ligjore për marrjen e pushimeve”*.

Nga ky konstatim i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kolegji i Këshillit si dëshmi materiale në provat e lëndës ka Raportin e prezencës në punë për periudhën 03.01.2023 deri 30.08.2023 për ankuesin dhe në bazë të këtij raporti konstatohet se ankuesi më datë 30.01.2023 është evidentuar në hyrje në punë në orën 10:22 ndërsa nuk evidentohet në dalje, më datë 06.02.2023 është evidentuar në hyrje në punë në orën 12:42 dhe nuk evidentohet se ka bërë dalje, më datë 16.02.2023 evidentohet se ka bërë hyrje në orën 09:58 ndërsa nuk evidentohet se ka bërë dalje, më datë 07.03.2023 nuk evidentohet që ka bërë hyrje në punë ndërsa ka bërë dalje në orën 12:15, më datë 16.03.2023 nuk evidentohet që ka bërë hyrje në punë ndërsa ka bërë dalje në orën 17:12, më datë 17.03.2023 nuk evidentohet se ka bërë hyrje në punë ndërsa ka bërë dalje në orën 15:34, më datë 24.03.2023 nuk evidentohet se ka bërë hyrje në punë ndërsa ka bërë dalje në orën 17:06, më datë 18.05.2023 është evidentuar në hyrje në punë në orën 08:47 ndërsa nuk ka bërë dalje, më datë 19.05.2023 nuk ka bërë hyrje në punë ndërsa ka bërë dalje në orën 13:41, më datë 23.05.2023 nuk ka bërë hyrje në punë ndërsa ka bërë dalje në orën 16:52.

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se në rastin konkret Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të konstatoj në mënyrë të drejtë gjendjen faktike ngase nuk ka evidentuar në mënyrë të saktë mungesën në punë nga ana e ankuesit, kështu që meqenëse Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka shqyrtuar vetëm një nga pretendimet e inicuesit të procedurës disiplinore atëherë përmes Vendimit me Nr. 03/2023 të datës 29.06.2023, ankuesit i ka shqiptuar *“Ndalimi i 40% në pagë për periudhën 6 muaj si dhe ndalimi i ngritjes në detyrë duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 3 vjeçare”*, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale pasi që ka shqiptuar dy masa disiplinore dhe atë masën disiplinore të ndalimit të pagës sipas nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe masën disiplinore sipas nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke vepruar

kështu në kundërshtim me nenin 50 paragrafi 5 të këtij ligji ku është përcaktuar se: *“Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore”*.

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesën e ankuesit, konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me rastin e shqyrtimit të rastit të ankuesit nuk ka arritur të konstatoj saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht Vendimi me Nr. 03/2023 i datës 29.06.2023 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nuk përmban dispozitiv të qartë, po ashtu edhe arsyetimi është kundërthënës dhe i paqartë siç parashihet me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ndërsa arsyetimi i tij është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 48 të këtij ligji, i cili parasheh se: *“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”*.

Nga të lartcekurat, Kolegji i Këshillit, meqenëse konstaton se Vendimi me Nr. 03/2023 i datës 29.06.2023 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale dhe materiale, atëherë i njëjti sipas Kolegjit të Këshillit është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që në kuptim të dispozitave ligjore të zbatueshme të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit është i obliguar në që të rishqyrtoj rastin e ankuesit dhe në ri procedurë të mënjanojë shkeljet procedurale duke i shqyrtuar të gjitha pretendimet e inicuesit të procedurës disiplinore dhe varësisht nga provat materiale të vendos në pajtim me legjislacionin për zyrtarët publikë dhe dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.951/2023, datë 23/08/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;;
- Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

